

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN PËR

MIRATIMIN E STANDARDEVE PËR ZONAT DHE PARCELAT E TOKËS NË TË CILAT DO TË LEJOHET KULTIVIMI I BIMËS SË CANNABIS-IT PËR QËLLIME MJEKËSORE DHE INDUSTRIALE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e standardeve për parcelat e tokës dhe zonat ku lejohet kultivimi i *Cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Këto standarde janë materializuar në tregues të parcelës së tokës dhe terreneve kultivuese, ku do të kultivohet bima e *Cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale.

Projektvendimi ka objektiv përcatimin e unifikuar të standardet për parcelat e tokës, terrenet dhe ambientet kultivuese, ku do të lejohet kultivimi i *Cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale që janë pjesë e sipërfaqes së tokës në shërbim të subjekteve që autorizohen ose licensohen – varësisht nga objekti i aktivitetit që kryejnë në bazë të Ligjit nr. Nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi hartohet dhe synohet miratimi si detyrim nga Ligji Nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale” në shkronjën c, të pikës 2 të nenit 9, ka përcaktuar miratimin e standardeve për zonat dhe parcelat e tokës, në të cilat do të lejohet kultivimi i bimës së *Cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale.

Kryerja e aktivitetit të kultivimit duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 61/2023, por dhe përcaktimet e këtij vendimi. Projektvendimi njëkohësisht përcakton përjashtimin e kultivimit si të *Cannabis*-it mjekësor dhe atij industrial, brenda territorit të zonave të mbrojtura dhe atyre me përparësi zhvillimin e turizmit sipas përcaktimeve si të tilla me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe/ose të autoriteteve të planifikimit të territorit. Aktualisht janë në fuqi vendimet si vijon:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 21.11.20018, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër - Fier;
- VKM nr. 708, datë 21.11.2018, “Për regjistrimin dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Vlorë - Sarandë”;
- Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 26.7.2018, “Për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimin e turizmit në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe hartën për këto zona”.

Pra, brenda territorit të zonave të shpallura me vendim të autoritetit përgjegjës, pavarësisht se ato janë në territorin e zonave kadastrale ku lejohet kultivimi në rastin e canabisit për qëllime industriale, nuk do miratohen licenca dhe leje për kultivimin dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera ndihmëse të lejuara nga Ligjin Nr. 61/2023. Gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesave do të behet verifikimi nëse pasuria ku do ushtrohet aktiviteti ndodhet në zonë të mbrojtur ose zonë me përparësi zhvillimin e turizmit, dhe konstatimit nëse ndodhet brenda territorit të tyre, kërkesa refuzohet.

E njëjta procedurë verifikimi ndiqet dhe për zonat dhe parcelat që mund të ndodhen në zonat ushtarake, që lidhen me sigurinë kombëtare ose të sistemit urban sipas dokumentave të planifikimit urban, apo ku kërkesat shqyrtohen rast pas rasti dhe refuzohen nëse ndodhen në territorin e zonave ku nuk lejohet.

Po ashtu nuk do lejohet kultivimi në zonat e përcaktuara si urbane nga dokumentat e miratuara të planifikimit të territorit të miratuara nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Por në dispozitat e fundit është parashikuar si përjashtim që në rast se mbjellja bëhet në ambiente të mbyllura ose të mbrojtura atëherë mund të kryhet dhe në zonat urbane.

Projektvendimi ka pjesë përbërëse shtojcën 1, ku përcaktohen vlerat maksimale të lejueshme të përqëndrimit të metaleve të rënda në tokë të shprehura në miligram për kilogram në një mostër përfaqësuese toke. Ky standard zbatohet vetëm në kultivimin e *Cannabis*-it për qëllime mjekësore pasi kjo bimë ka aftësi të akumulojnë sasi të madhe të metaleve të rënda. Me anë të produkteve mjekësore, metalet e rënda kalojnë te njeriu duke ndikuar në shëndetin e tij. Konkretisht, kur bima kultivohet për prodhimin e barnave mjekësore, ato përdoren si pjesë e trajtimeve mjekësore dhe mbetjet e metaleve të rënda depozitohen në trupin e njeriut me pasoja negative afatgjata për shëndetin. Ndërkohë kultivimi i *Cannabis*-it për qëllime industriale nuk lidhet me shëndetin e njeriut por përdoret në industri dhe nuk krijon pasoja, ndaj nuk përcaktohet një standart i tillë. Të dhënat maksimale në shtojcë janë vendosur vetëm për metalet e rënda për të cilat bima e *Cannabis*-it ka afinitet për t'i përpthithur dhe që më pas qarkullojnë në formën e radikaleve të lira duke u përçarur te produkti përfundimtar që konsumohet nga njeriu nëpërmjet barnave mjekësore. Gjatë hartimit të projektvendimit është konstatuar se Bashkimi Evropian nuk ka legjislacion ku përcaktohen vlerat maksimale të metaleve të rënda dhe u morën si referencë ato të përdorura nga Finlanda, vend anëtar i BE-së (*miratuar me dekretin Nr. 214/2007, datë 1 mars 2007*), mbi vlerësimin e ndotjes së tokës dhe nevojave për rehabilitim. Nga materiali i përdorur janë marrë të dhënat që lidhen me kontekstin në Shqipëri lidhur me përbërjen e tokës, klimën dhe mjedisin konkret. Po ashtu përcaktohet se toka apo terrenet kultivuese (substrakte të kontrolluara), ku kultivohet *Cannabis*-i mjekësor duhet të plotësojnë standardet e parashikuara në udhëzuesit për Praktikën e Mira Bujqësore dhe Grumbullimin të Agjencisë Evropiane të Barnave dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe standardet e parashikuara nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO).

Vendosja e kriterit të largësisë prej 3 km, në rrugë ajrore, larg parqeve të bletëve, të miratuara sipas legjislacionit për bletarinë, lidhet me dëmet që mund të shkaktojnë në parqet e bletëve, sepse dëmi është i konsiderueshëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim hartohet në mbështetje të neneve 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c)”, të pikës 2, të nenit 9, të Ligjit Nr. 61/2023, “*Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së Cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale*”.

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në harmoni me legjislacionin vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrimin me legjislacionin e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim përbëhet nga 3 (tre) krerë dhe shtojca 1 bashkëlidhur vendimit dhe që është pjesë përbërëse e tij.

Në kreun e parë përcakton përkufizimet për termat që përdoren në këtë vendim.

Në kreu e dytë përcakton standardet për zonat dhe parcelat ku do të kultivohet *Cannabis*-i mjekësor dhe industrial dhe ka 2 pika të cilat kanë rregullime të mëvetësuarra për kultivimin e cannabisit për qëllime mjekësore dhe industriale, pika 3 që i përfshin të dyja rastet, ndërsa pika 4 i referohet vetëm kultivimit për qëllime mjekësore.

Në kreun e tretë “Dispozitat e fundit” përcaktohen dispozitat e fundit, me një pikë që synon përjashtimin nga rregullat e përgjithshme të kreut 2, organet që ngarkohen me zbatimin e vendimit dhe hyrjen në fuqi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi u hartua nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe u dërgua për mendim në Minisritë e Linjës dhe Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabisit. Gjatë hartimit dhe dërgimit për mendim janë reflektuar komentet e MTM-së për të mos lejuar kultivimin në "pyje", "livadhe", "kullota" dhe në zonat e mbrojtura dhe ato me përparësi zhvillimin e turizmit, sugjerime të marra në konsideratë në këtë projektvendim.

Projektvendimi u ripunua dhe dërgohet për bashkërendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Mbrojtjes, Agjencinë Kombëtare të Cannabis-it dhe Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Lidhur me komentet e Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabisit dhe ministrive të linjës :

1. MTM ka sugjeruar që të shtohet pas togfjalëshit, "pjesë e njësisë së prodhimit, nuk mund të shtrihen në zona të mbrojtura" të shtohet "fondin pyjor dhe kullor kombëtar".

Sugjerimi u reflektua dhe nuk do lejohet kultivimi në fondin pyjor dhe kullor kombëtar. Përcaktimi në këtë projektvendim vlerësohet në harmoni me vendimin për përcaktimin e zonave kadastrale dhe pavarësisht se në zonat kadastrale ka dhe fond pyjor dhe kullor kombëtar. Pra, komenti i MTM është mbajtur në konsideratë në të dy projektvendimet.

2. MF dha dakordësinë pasi e vlerëson jashtë fushës së përgjegjësisë.

Projektvendimi nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit.

3. Ministria e Drejtësisë u shpreh parimisht dakord me sugjerime. Projektvendimi u ripunua për shkak të komenteve të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabisit dhe ministrive të tjera.

a. Projektvendimi u strukturua me krerë të mëvetësuar për rregullime që lidhen me kultivimin si për qëllime industriale ashtu dhe për qëllime mjekësore, ndërkohë kreu për përkufizimet, dhe kreu i fundit janë ndryshuar në përmbajtje.

b. Lidhur me sugjerimin për kultivimin në substrakte të tjera dhe jo në tokë, sqarohet se në të dyja rastet lejohet kultivimi/mbjellja jo në tokë, kjo, pasi menyrat dhe teknologjitë e kultivimit në bujqësi zhvillohen në funksion të rritjes dhe prodhimit. Ligji nuk e kushtëzon kultivimin vetëm në tokë bujqësore dhe qëllimisht përcakton termat “tokë”, “parcelë”, apo “zonë”, me qëllim shfrytëzimin e territoreve të tjera. Normalisht kultivimi i çdo bime bëhet në tokë bujqësore por mënyrat dhe teknologjitë e reja, si shembull përfshihen mbjellja në vazo e cila ka substrakt, ka të njëjtin qëllim që është prodhimi nga bima. Por nuk është e nevojshme që ligji të përcaktojë që mund të ketë mbjellje në substrakt pasi është mënyrë kultivimi të cilat ndryshojnë varësisht nga zhvillimet teknologjike. Lidhur me vlerat maksimale të metaleve të rënda në shtojcë janë parashikuar ato maksimale që nuk mund të ketë toka në rastin e kultivimit në tokë të bimës së cannabisit për qëllime mjekësore e cila ka aftësi përthithëse dhe më tej mund të përcillet te njëriu. Ndërkohë substraktet nuk përmbajnë metale të rënda.

c. Nga përcaktimi i subjekteve që ngarkohen për zbatimin e vendimit u hoqën subjektet private që do licensohen/autorizohen.

4. Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabisit dha sugjerime.

a. Projektvendimi u ripunua në tërësi dhe u riformuluan përkufizimet e integruara në kreun 1 të projektvendimit.

b. U riformulua kreu 2, në varësi të komenteve të AKKC dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

c. U ripunua Shtojca nr. 1, për vlerat referuese për përqëndrimin e metaleve të rënda në tokë duke vendosur vetëm vlerat maksimale të lejuara. Në legjislacionin e BE-së nuk ka akte që përcaktojnë vlerat dhe janë përdorur nga akti i cituar në kreun III të këtij vendimi, nga i cili është nxjerrë vetëm pjesa që vlen për kontekstin në Shqipëri.

ç. Sugjerimi për konsultim publik me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Industrisë së Kërpit dhe dërgimin për mendim në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore u mor parasysh.

Projektakt i ripunuar dërgohet paralelisht në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe është parashikuar takim me Shoqatën.

d. Lidhur me sugjerimin sipas pikës 7, në projektvendim është integruar termi “zona urbane” sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Ky përkufizim sjell zgjidhje dhe për sugjerimet e pikës 11 për sa i përket qendrave të banuara, arsimore, institucionet shëndetësore, zonat e mbrojtura, zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

dh. U reflektua sugjerimi sipas pikës 8, duke u shtuar togfjalëshi “në rrugë ajrore”.

e. Lidhur me sugjerimin sipas pikës 10 u ripunua shtojca bashkëlidhur vendimit. Përcaktimet në shtojcë sikurse është shpjeguar më lart janë marrë nga akt zyrtar i Finlandës por vetëm për pjesë që mund të përdoren në Shqipëri.

ë. Lidhur me sugjerimin për dërgimin për mendim në Ministrinë e Brendshme projektvendimi dërgohet pas ripunimit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk shoqërohet me kosto financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

MINISTËR

Anila Denaj

